

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dëshmia në SPAK - Pagat e magjistratëve/ Shefja e Thesarit, Tiranë: Kreva pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/917609/pagat-e-magjistrateve-shefja-e-thesarit-tirane-kreva-pagesen-e-muajit-gusht-2026-rrogat-i-blokoi-malaj/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 13:45:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:27:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d9f16bce4932c682b4961af15debfa3e920560262e8d64c9bf878891c58406b7
TEKSTI	790c66745d78388299f3506f7b20d449b56de688647c7765dc61fd5c4204c6ab
PAMJA	b18ea674d516d2e4e992703b1c46b041651244fa1319f8b3fc8edd715610528d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	de06954fd339357e38e35f410671409b2ec0ecfd3f08a54e568fdf4b3e3b5e60
E MËPARSHMJA	0d7fbc4cb7952f9007a78212786111afd1cb3dcc89386bf1d09a7c5f9a53991a
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/de06954fd339357e38e35f410671409b2ec0ecfd3f08a54e568fdf4b3e3b5e60>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



më të lexuarat

Sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj pronarëve

Blokimi i pagave të gjyqtarëve/ SPAK merr në pyetje përgjegjësen e Thesarit, ja çfarë dimë deri tani

**Pagat e magistratëve/ Shefja e Thesarit, Tiranë: Kreva pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...**

15:27, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Elton Qyno Syri.net

Përgjegjësjë e Thesarit Tiranë, Elmira Peti, është marrë sot në pyetje nga prokuroria e Posaçme SPAK, duke deklaruar para oficerëve të BKH-së, se nuk ka kryer asnjë abuzim me detyrën dhe shkelje ligjore.

Në rrëfimin e saj, Peti, ka pohuar se pagesat e muajit Gusht 2026 për administratën civile dhe magistratët prokurorë dhe gjyqtarë, ajo i kishte kryer.

Sipas zyrtares më të lartë të Thesarit në sistem këto pagesa vijnë të jenë ende të paguara, por një urdhër i marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, që drejtohet nga Petrit Malaj, ka sjellë bllokimin e rrjedhjes së pagesave në llogaritë bankare të punonjësve.

Për të verifikuar dëshminë e Elmira Peti, SPAK ka kryer kçyrjen e sistemit elektronik të pagesave në Thesarin e Shtetit, ku rezultoi se pagat për gjyqtarë dhe prokurorë, përfshirë dhe administratën civile, ishin paguar.

Mirëpo në momentet e fundit, Gentian Këri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, vendosi të urdhërojë bllokimin e tyre.

Sot e kësaj disa pjesa dërrmuese e pagave për muajin Gusht 2026 për pjesën më të madhe të gjykatave dhe prokurorive të vendit, nuk kanë kaluar.

Për shkak të këtij urdhëri, Gentian Këri, është marë në pyetje duke deklaruar se pagesat janë bllokuar për shkak se në ministrinë e Financave, kishte mbëritur projekt-ligji me qëllim zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Sipas tij në momentin që do hyjë në fuqi ligji për rritjen e pagave për gjyqtarë e prokurorë, menjëherë pagesat do lirohen. Vetëm 3 institucione kanë marrë pagesën në kohë, si prokuroria e posaçme SPAK, Gjykata Kushtetuese dhe Shkolla e Magistraturës.

Shpërthim në Shijak! Zbulohet emri i pronarit të banesës ku u vendos eksplozivi

Arrestohet në flagrancë një efektiv policie, dy të tjerë hetohen në gjendje të lirë

Shortohet seanca për Ergys Agasin e Ulian Shpatarakun- Ja kush gjyqtar e ka në dorë

I dhunojnë dhe arrestojnë/ Policia prangos 12 protestues se thirrën: Rama jepe dorëheqjen

Kjo pasi këto 3 institucione kanë çuar zëra të vjetër të referencës financiare dhe jo ato të parashikuara nga gjykata Kushtetuese dhe reflektuara më pas me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Pas përplasjes për pagat, 18 drejtues gjykatash dhe dy krerë të shoqatave të gjyqtarëve e prokurorëve kallëzuan në SPAK ministrin e Financave, Petrit Malaj, sekretarin e përgjithshëm të ministries, Gentian Këri dhe drejtuesve të degëve të Thesarit në 14 rrethe.

Ndërkohë në orët e vona të mëngjesit të sotëm, maxhoranca miratoi e vetme projekt-ligjin për statusin e gjyqtarit, i cili parashikon një rritje të pagës referuese me rreth 8,500 lekë sa 0.02 për qind, e pagës së Presidentit.

Një rritje kjo, disa herë më pak se paga baza referuese prej 222 mijë lekësh dhe 14 mijë lekë shtesë për kualifikimin që kishte përcaktuar Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të afatit nga Gjykata Kushtetuese.

Projekt-ligji, i cili u hodh për votim në orët e vona të natës kaloi me 84 vota pro të maxhorancës, ndërsa 24 deputetë të PD votuan kundër.

Po kështu qeveria ka përllogaritur edhe 1.5 miliardë lekë detyrime të prapambetura nga prilli 2023, të cilat do të shlyhen me këste brenda dy viteve.

Kuvendi miratoi formulën e re për pagat e magjistratëve, por përplasia mes qeverisë dhe institucioneve të drejtësisë vijon tashmë në rrugë gjyqësore.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Grabitet apartamenti i kardinalit Ernest Simoni në Firence, ja çfarë morën hajdutët.... Nipi: Kur e njoftova më pyeti për



Emri i një pensionisti u përdor për ndryshimin e 45 identiteteve. Pezullohen 2 zyrtarë, Indrit Aliu shpallet në kërkim



Zjarr në sektorin Rinia në Durrës

Laboratori i heroinës në Has dhe dosja '339', arrestohet në Belgjikë Jasin Avdyli! Fitimet i investoi në dy lokale në Shijak

Shtyhet seanca ndaj Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit, mungoi anëtarë i trupit gjykues

Arratisje si në filma/ Forcat speciale spanjolle arrestojnë shqiptarin me ... mbi 80 precedentë penalë

TË NGJASHME



SYRI TV - Zhdukuri shishet e verës miliona euro/ Burg kushëririt të Ergys Agasit, dosja i kalon SPAK



Makina përplaslet me barrierat në aksin Elbasan-Peqin, plagoset një grua dhe një fëmijë



SYRI TV/ Plagosja e kolegut, avokatët në Durrës bojkotojnë seancat për rreth 2 orë



25-vjeçari rrëshqet aksidentalisht në lokal, nisët me helikopter drejt Traumës



Kultivonte bimë narkotike në mes të pyllit, pranga 37-vjeçarit në Mirditë



EMRAT/ Arrestohen në Itali dy shqiptarë, ja për çfarë akuzohen



Shortohet seanca për Ergys Agasin e Ulian Shpatarakun- Ja kush gjyqtar e ka në dorë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.